



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim Letrar**

Ngarkesa: 3kredite; 30 orë mësimore; 10 leksione/20 seminare

Viti akademik: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në Përkthim-Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Ky kurs ofron një hyrje në teorinë dhe praktikën e përkthimit letrar. Studentët do të mësojnë të analizojnë dhe përkthejnë tekste letrare nga zhanre dhe epoka të ndryshme, duke marrë parasysh aspektet kulturore, stilistike dhe gjuhësore.

Objektivat specifike lëndorë:

Studentët do të praktikojnë përkthimin e teksteve të ndryshme letrare, duke përfshirë poezi, prozë dhe dramë, dhe do të marrin feedback për të përmirësuar punën e tyre. Ata do të aplikojnë teori të ndryshme të përkthimit në punën e tyre praktike për të kuptuar më mirë procesin e përkthimit. Studentët do të mësojnë të marrin parasysh kontekstin kulturor të tekstit origjinal dhe të synojnë përkthime që respektojnë dhe përcjellin këto kontekste. Studentët do të identifikojnë dhe zgjidhin probleme specifike të përkthimit, si përkthimi i idiomave, metaforave dhe referencave kulturore. Ata do të inkurajohen të reflektojnë mbi vendimet e tyre përkthimore dhe të diskutojnë sfidat dhe zgjidhjet e mundshme në grup.